



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.53/2019

Prishtinë, më 28.5.2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviç, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Mirjeta Kalludra, Shemsi Sylja dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Dragoljub Stojanoviç-SHF “V. Dugoshoviç”, Ranillug, Goran Petkoviç-SHF “Veljko Dugoshoviç”, Ranillug, Goran Zdbaucoviç-SHF “Veljko Dugoshoviç”, Ranillug, Ardiana Hajzeri-Radio Kosova, Nexhmije Hyseni-Ekonomia Online, Nexhmije Berisha-LjDK, Sanije Berisha-OSBE, Maria Berisha-OSBE, Dafina Jegeni – Klan Kosova, Gentianë Krasniqi-KDI, Zhaklina Peshiq- SHF “Veljko Dugoshoviç”, Ranillug, Ivan Kukalj-SHF “Veljko Dugoshoviç”, Ranillug, Katarina Ristiç- SHF “Trajko Periq”, Edona Hajrullahu-IAP, Merita Sylja-IAP, Zorica Simiq, Ivan Mitroviç-DPSH, Ranillug, Zoran Cveteluvij-SHF “Veljko Dugoshoviç” Ranillug, Lulzim Canaj, avokat i autorizuar në Komunën e Ranillugut, Xhavit Krasniqi, drejtor i Buxhetit dhe Financave në Komunën e Ranillugut, Emine Jakupi, praktikante, Liridona Ademaj-Kallxo.com, Kadrush Sylja, IPA dhe Shemsi Maqastena, prind i fëmijës së verbër dhe me dëmtime të shumëfishta.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Ajo propozoi që pika - Diskutim në komision, lidhur me kërkesën e disa punëtorëve të arsimit të Komunës së Ranillugut, të shqyrtohet si pikë nr. 1 e rendit të ditës.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

Në vazhdim, komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Diskutim në komision, lidhur me kërkesën e disa punëtorëve të arsimit të Komunës së Ranillugut.

Të ftuar: Vladica Aritonoviç, kryetare e Komunës së Ranillugut; Ivan Mitkoviç, drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit; Basri Ibrahim, kryeinspektor i punës; parashtrues të kërkesës; Hilmi Jashari – Avokat i Popullit dhe Shyqiri Bytyçi– Ministër i Arsimit.

2. Të ndryshme;

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

1. Diskutim në Komision, lidhur me kërkesën e disa punëtorëve të arsimit të Komunës së Ranillugut.

Të ftuar: Vladica Aritonoviç, kryetare e Komunës së Ranillugut; Ivan Mitkoviç, drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Basri Ibrahim, kryeinspektor i punës; parashtrues të kërkesës; Hilmi Jashari – Avokat i Popullit dhe Shyqiri Bytyçi– Ministër i Arsimit.

Kryetarja, tha se kanë kërkesën e disa punëtorëve të arsimit të Komunës së Ranillugut dhe për këtë janë ftuar përfaqësuesit e kërkesës dhe të disa institucioneve përgjegjëse që do t'i dëgjojmë për problemet që u janë paraqitur.

Katarina Ristiç, tha se punon në shkollën fillore “Trajko Periq” të Ranillugut, prej vitit 2016 nuk ka marrë pagë nga institucionet e Kosovës, kam tentuar të flasë me përfaqësues të komunës pse ka ardhur deri te kjo ngecje. Më tej, iu kemi drejtuar inspektoratit në Gjilan dhe ata na kanë përcjellë në Ministrinë e Punës në Prishtinë, edhe koleget e mia në shkolla të tjera kanë të njëjtat probleme dhe i kam udhëzuar si të veprojnë dhe kanë filluar të ankohen në mënyrën e njëjtë. Në gjykatën e Kamenicës kanë thënë që në mënyrë eksplicite të na kthejnë në atë listë të pagave dhe ata prapë kanë refuzuar të na kthejnë, nuk kam ndonjë arsyetim pse jam e diskriminuar, në raport me koleget e mia, të cilat i kanë diplomat e njëjta sikur unë dhe në rrethana të njëjta punojnë sikur unë.

Zorica Simiq, tha se punon në çerdhe nga viti 1981 dhe prej vitit 2014 e kanë larguar nga lista e pagave, pa asnjë arsye dhe kërkon vetëm një arsyetim, pse është diskriminuar, në krahasim me koleget tjerë.

Goran Petkoviç, tha se punoj si mësues në shkollën fillore në Rakonik dhe 16 mësimdhënës nga kjo shkollë jemi përjashtuar nga lista e pagave. Ministria e Punës, në vitin 2017 ka marrë vendim që punëdhënësi t'i kthejë punëtorët në listën e pagave dhe ky vendim në komunën tonë nuk është respektuar. Po ashtu, edhe Gjykata e Apelit ka marrë vendim në të mirën tonë. Kanë kaluar 5 vite dhe nuk e dimë se çka do të ndodhë dhe inspektorati i punës duhet t'i respektojë vendimet që i ka marrë.

Ivan Mitkoviç, drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Ranillugut, tha se ka qenë drejtor i shkollës së Ranillugut, gjithçka ka shkuar sipas ligjit, askush nuk ka ndonjë kontratë, por për shkak të mungesës së normës së plotë, sipas buxhetit të Kosovës dhe në bazë të numrit të nxënësve, nëse Ministria e Arsimit na jep buxhet shtesë, ne dëshirojmë që t'i kthejmë të gjitha këto. Ne, për çdo vit, shpallim konkurs për vitin e ardhshëm, sepse me këto kushte asnjë nuk ka kontratë të përhershme.

Kryetarja pyeti: Në bazë të cilave kritere hapeni konkurs për çdo vit për stafin arsimor?

Iva Mitkoviç, tha se kemi vepruar në bazë të kriterëve që i parasheh ligji dhe këta persona nuk i kanë plotësuar kriteret në shkollat ku punojnë. Kemi një normë dhe atë normë nuk mund t'ua japim dy apo tre personave. Ne kemi 89 norma, ndërsa me sistemin serb 260 norma dhe kur të bëhet përpjesëtimi, nuk mund të marrin të gjithë mjete, sepse nuk plotësohen kriteret.

Xhavit Krasniqi, drejtor i Buxhetit dhe Financave në Komunën e Ranillugut, tha se të gjithë ankohen që nuk janë në regjistër të pagave. Ata që kanë vendim të punës përmes konkursit ose përmes emërimeve politike, të gjithë janë në listë të pagave. Ne, përveç limitimeve në buxhet, kemi limitim edhe në numrin e stafit. Çdo vit, në arsim i kemi 98 norma, nuk mundemi ne si komunë t'i marrim të gjithë në marrëdhënie të punës. Ata që janë me sistem paralel të Serbisë, sepse nuk kemi bazë ligjore, vendime të përhershme të punës nuk mund të lëshojmë, në momentin që nuk janë të licencuar, sepse nuk mund të shkelim ligjin.

Kryetarja theksoi se me sa e di, asnjëri nuk ka nostrifikim të diplomës, si keni bërë klasifikimin e atyre që janë në listë të pagave, çfarë kriterë keni marrë për bazë apo nëse është në listën serbe, është në listën e pagave, nëse nuk është në këtë listë, nuk është as në listën e pagave.

Xhavit Krasniqi, tha se punon me ligjet e Republikës së Kosovës.

Lulzim Cana, avokat i autorizuar, përfaqësues i Komunës së Ranillugut, tha se organet gjyqësore e kanë dhënë fjalën e vet dhe ato vendime janë shumë në rregull dhe ligjore. Në asnjë moment nuk u janë shkelur të drejtat e njeriut. Procedurat kanë qenë të hapura, legale, ndërsa për nostrifikim të diplomave është përgjegjëse Ministria e Arsimit.

Veton Berisha, tha se shkresa na ka ardhur në cirilik, po diskutohet për vendime të gjykatave, ne nuk i kemi. Mendoj që nuk mundemi, që të vazhdojmë më tutje me shqyrtimin e kësaj pike, derisa nuk i kemi të gjithë dosjen e plotë.

Sasha Milosavljeviç, tha se kemi marrë rolin e gjykatës dhe ne nuk kemi kompetencë të vendosim a janë këto diploma valide apo jo, si dhe duhet të respektohen disa çështje. Pra, kemi mandat të flasim se a janë shkelur të drejtat e njeriut të këtij komuniteti.

Edona Hajrullahu, tha se për institucionin është hera e parë që dëgjojnë për problematikën, pasi që nuk janë adresuar palët. Një ankesë, zonja e ka adresuar në vitin 2016 dhe është trajtuar nga përfaqësuesi i IAP, në Komunën e Gjilanit dhe është përcjellë deri në momentin që është ngritur aktakuzë dhe ka përfunduar aty. Nëse ekziston një vendim i prerë i gjykatës, atëherë patjetër që mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë, përbën shkelje të të drejtave të njeriut, por pasi nuk e kemi dosjen e kompletuar, është herët për të konstatuar kush ka të drejtë e kush jo.

Teuta Haxhiu, materialin nuk e kam kuptuar, për shkak të gjuhës në të cilën ka qenë e shkruar. Ne duhet ta trajtojmë këtë temë në grupin punues për shqyrtimin e peticioneve dhe lus të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, prezentë, që t'i respektojnë ligjet dhe plan-programet e vendit,

për çka edhe kërkohet të marrin një pagë. Kërkoj që këta mësues t'i mësojnë dhe t'i edukojnë fëmijët, që ta duan dhe të punojnë për vendin e vet, pra këta mësues të kërkojnë edhe rritje të pagave nga vendi i vet.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se kërkesa është në alfabet cirilik dhe e ka penguar për të kuptuar saktë. Për zonjën Katarina, uroj që të gjitha që i ka listuar këtu t'i ketë paraqitur edhe në gjykatë. Çështja e juaj është në procedurë. Ne nuk kemi dokumente shtesë, me arsyetimin pse u kanë larguar nga vendi i punës. Pra, u tha që për çdo vit, ju u nënshtroheni konkurseve, sepse nuk jeni të licencuar, dhe në qoftë se nuk pranoheni në vendin e punës, Drejtoria e Arsimit duhet ta lëshojë një arsyetim pse ju nuk i keni plotësuar kushtet për vendin e punës, derisa keni përvojën e punës, a i keni kriteret, pse ua kanë anuluar vendin e punës? Këtë lëndë do ta trajtojmë edhe në grupin punues për shqyrtimin e peticioneve.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se si deputetë nuk guxojmë të ndërhyjmë në organet e gjyqësorit, t'i lihen kompetencat organit të gjyqësorit, si institucion i pavarur. Kosova është shtet sovran dhe i pavarur, e ka një Kushtetutë dhe secili qytetar që jeton në Kosovë duhet ta respektojë këtë Kushtetutë dhe ligjet e Kosovës dhe të bëjmë përpjekje të punojmë me një sistem. Ajo theksoi se nuk guxojmë të krijojmë asnjë formë të veprimit paralel.

Lirije Kajtazi, tha se kjo situatë nuk është e thjeshtë, por ajo që po del në pah është se arsimimi paralel serb në Kosovë po bëhet përditë e më shumë, po e minon edhe shtetësinë e Kosovës, madje nëpër tekstet serbe edhe infiltron politika, duke përçuar mesazhe urrejtjeje dhe nuk po dihet a po mbjellët farë lufte apo arsimim. Është e rëndësishme për t'i kontribuar arsimimit të secili nxënës. Është mirë, si komision, ta vizitojmë atë komunë dhe të shohim që atyre nxënësve, me të vërtetë u shkelen të drejtat, duke u indoktrinuar dhe duke promovuar luftëra e jo paqe dhe mirëkuptim.

Katarina Ristiç, tha se ne i kemi dokumentet dhe konkurset që po shpallen çdo vit dhe askund nuk shkruajnë kushtet që të kemi diploma të licencuara apo të nostrifikuara. Më tej, foli për disa padrejtësi që u janë bërë në dallim me kolegët e tyre dhe kërkoi që të gjithë të jenë të barabartë para ligjit.

Kryetarja, tha se do të vizitojmë Komunën e Ranillugut, ku mund të konstatojmë për diskriminim, por nuk do të jetë ky takimi i fundit për këtë çështje, do të ndihmojmë edhe IAP, lidhur me këtë çështje.

2. Të ndryshme

Kryetarja, tha se kemi prezent prindin e një fëmije me aftësi të kufizuara, i cili do të paraqesë problemet, me të cilat ballafaqohet.

Shemi Maqastena, prind i fëmijës së verbër dhe me dëmtime të shumëfishta, është edhe anëtarë i bordit të shkollës së Pejës. Ai tha se duke pasur parasysh problemet dhe sfidat, me të cilat është ballafaquar fëmija i tij dhe fëmijët tjerë, ka formuar edhe një shoqatë. Si familjarë të fëmijëve të verbër dhe me dëmtime të shumëfishta, janë në situatë shumë të vështirë dhe të palakueshme. Ai, më tej, tha se e ka fjalën për Qendrën Burimore në Pejë. Kjo shkollë, prej shtatorit ka pranuar fëmijë të verbër dhe me dëmtime të shumëfishta, që janë 16 fëmijë. Ai kishte vërejtje për një mësuese të kësaj qendre, e cila ka bërë një ankesë për kujdestari dhe

inspektorët e punës e marrin një vendim që të gjithë fëmijët e verbër dhe me dëmtime të shumëfishta t'i largojnë në mënyrë indirekte nga shkolla, dhe fatbardhësisht, pjesa tjetër e stafit të kësaj shkolle, të cilët e kryejnë punën në baza vullnetare, falë tyre, vajza e tij vazhdon të shkojë në shkollë. Ai tha se është drejtuar edhe te kryeinspektori i punës, Basri Ibrahim. Më tej, tha se krejt zanafilla e problemit janë inspektorët e punës në Komunën e Pejës. Më 27 mars ka bërë kërkesë te Avokati i Popullit, për takim dhe është 28 maji, ende nuk ka mundur të takohet me të. Dera e këtij institucioni ka qenë shpresa e fundit që ka menduar që t'i bëhet zgjidhje fëmijës së tij dhe ky institucion nuk ka gjetur kohë për takim, që t'i dëgjojë hallet e tij, si prind. Ai tregoi se fëmija i tij ka qenë fëmija i parë i verbër dhe me dëmtime të shumëfishta, që ka arritur të shkojë në kopsht, falë insistimit të tyre.

Teuta Haxhiu, tha se ishin në monitorim të ligjit, me Komisionin për Arsim, në këtë qendër dhe ky rast ishte i ndjeshëm dhe kanë vendosur që këtë prind ta ftojnë në këtë mbledhje. Ajo tha se kjo shkollë ka kujdes 24 orë për këta fëmijë dhe është vendosur një orar i kujdestarisë, por njëra prej kolegeve të punës nuk e ka respektuar këtë orar. Si komision nuk do të ndalen me kaq dhe do të kërkojnë përgjegjësi nga ata që janë përgjegjës. Ajo pyeti se a i është drejtuar me kërkesë edhe Avokatit të Popullit.

Shemsi Maqestena, tha se për kushtet që eksitojnë brenda stafit, janë të kënaqur me punën që ofrojnë stafi brenda shkollës. Te IAP ka shkuar te ndërtesa, ndërsa sa i përket kujdestarisë, një mësueses i bie të kujdestarojë njëherë në të 9-ën javë, prej orës 20:00 në mbrëmje deri në orën 6:00 në mëngjes.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se është shqetësuese puna e inspektoratit në Komunën e Pejës. Vendimet e tyre bien ndesh me normat ligjore. Më tej, tha se ishin në Zyrën e Inspektoratit të Arsimit në Komunën e Pejës, megjithatë nuk kishin një vendim final se çka është bërë, por ishin në dijeni se është bërë një shkelje dhe u arsyetuan se janë vetëm tre inspektorë dhe kanë vëllim të madh të punëve. Lidhur me këtë, do të punojnë për këtë çështje edhe me Komisionin e Arsimit, edhe me Komisionin për të Drejtat e Njeriut.

Kryetarja theksoi se do të kërkojmë një mendim nga Avokati i Popullit, për këtë çështje, dhe në bazë të atij mendimi, të ndërmarrim hapa të tjerë.

Saranda Bogujevci, tha se të gjitha materialet që i keni, është mirë t'i kemi, pastaj të takohemi me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe me Inspektoratin, për të tërhequr vendimin, e nëse jo, atëherë të ndërmerren hapa, që gjykata të përshpejtojë shqyrtimin e kësaj lënde.

Anëtarët e komisionit shprehen indinjatën për mosprezencën e ministrit të Arsimit në mbledhjen e komisionit, dhe thanë se duhet t'i bëhet një shkresë ministrit, në emër të komisionit.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Komisioni nuk pati kuorum për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më dt. 16 prill.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje